

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“F.S.L RENEWABLE ENERGY” SHPK

Sot, më datë 15/09/2022, ortakët si më poshtë:

1. **Z. Ferit Zavalani**, shtetas shqiptar, atësia Xhafer, lindur me 14.10.1955, lindur në Tiranë dhe banues në Tirane, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtes i letërnjoftimit nr. 034872525 dhe nr. personal F51014081F;
2. **Z. Lenoks Milla**, shtetas Shqiptar, atësia Artan, lindur më 14.10.2000 në Ndroq dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me Pasaporten me Nr. BD3200579 dhe nr. personal K01014054L;
3. **Shoqëria “ERMIR-STAR” shpk.**, person juridik, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të regjistrimit me NUIS L22015007K, me seli në adresën Rr: “George W. Bush”, Kulla Fati, Kulla e Parë, Kati i 1, Tiranë, përfaqësuar nga Administratori z. **Romeo Lamçe**, shtetas Shqiptar, lindur më 31.01.1982 në Lushnje dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtes i letërnjoftimit nr. 037269430 dhe nr. personal I20131124E.

Vendosën të hartojnë këtë Akt Themelimi, me përmbajtje si më poshtë:

NENI 1
DATA E THEMELIT

Sot, më datë 15/09/2022, themeluesit Ferit Zavalani, Lenoks Milla dhe shoqëria “ERMIR-STAR” vendosën të krijojnë një shoqëri me emërtimin “F.S.L RENEWABLE ENERGY” SHPK.

NENI 2
FORMA E SHOQËRISË


Kjo shoqëri do të jetë me përgjegjësi të kufizuar (SHPK) derisa të vendoset ndryshe për shndërrimin në një formë tjetër ligjore të parashikuar nga legjislacioni për shoqëritë tregtare.

NENI 3
EMËRTIMI

Emri i plotë i shoqërisë është “F.S.L RENEWABLE ENERGY” shpk.

NENI 4
SELIA

Selia e shoqërisë do të jetë në adresën: Rr. “Dritan Hoxha”, Pallati “Nord Construction”, mbrapa Tirana Ring Center, Kati 5, Ap. 46, H. 1, Njesia administrative Nr. 7, Tiranë.



Me miratim te organeve te saj, shoqëria mund të ndryshojë selinë, mund të hapë degë, filiale, përfaqësi dhe agjenci operative në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë apo jashtë saj.

NENI 5 KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

Shoqëria fiton personalitetin juridik në datën e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe nga kjo datë ajo mund të fillojë të ushtrojë aktivitetin tregtar deri kur me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të vendoset prishja e shoqërisë ose kur shoqëria mbaron në një nga mënyrat e parashikuara në ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

NENI 6 OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Shoqëria “F.S.L RENEWABLE ENERGY” shpk do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj:

Prodhimi, transmetimi, shpërndarja dhe shitja e energjisë elektrike. Ndërtimi, operimi dhe vënia në punë e parqeve fotovoltaike. Prodhimi i energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme, impiantet fotovoltaike etj., pa u kufizuar. Ndërtimi, operimi dhe vënia në punë e hidrocentraleve. Prodhimi i gazit, shpërndarja e lëndëve të gazta nëpërmjet tubacioneve. Prodhimi, transmetimi, shpërndarja e energjisë elektrike të prodhuar nga hidrocentralet. Ndërtimi i parqeve fotovoltaike dhe prodhimi i energjisë nga burimet e rinovueshme. Projektimi, ndërtimi, rehabilitimi dhe fuqizimi i centraleve për prodhimin e energjisë dhe infrastruktura e impianteve. Prodhimi, transmetimi, shpërndarja e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme. Importi dhe eksporti i mallrave dhe pajisjeve të teknologjisë në fushën e energjitikës, që do të përdoren në ndërtimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e hidrocentraleve. Mirëmbajtja e centraleve energjitike etj., si dhe çdo lloj aktiviteti tjetër tregtar që lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e veprimtarisë dhe që është në përputhje me legjislacionin në fuqi.

NENI 7 KAPITALI

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë 1.000.000 (një milion) Lekë, i zotëruar plotësisht nga ortakët si më poshtë:

Emri	Perqindja %	Kuota (pjesë)	Vlera e Pjesmarrjes
Lenoks Milla	34 %	1	340,000 (Lek)
Ferit Zavalani	33 %	1	330,000 (Lek)
“ERMIR-STAR” Shpk	33 %	1	330,000 (Lek)

Ky kapital është i ndarë në 3 (tre) kuota të zotëruara nga tre ortakët.

Kapitali themeltar do të depozitohet ne një Bankë në Shqipëri, me një llogari të hapur në emër të shoqërisë në formim e sipër.

NENI 8
ADMINISTRATORI

Administratori i parë i shoqërisë "F.S.L RENEWABLE ENERGY" shpk do të jetë:

Administrator i parë i shoqërisë do të jetë **Z. Lenoks Milla**, shtetas Shqiptar, atësia Artan, lindur më 14.10.2000 në Ndroq dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me Pasaporten me Nr. BD3200579 dhe nr. personal K01014054L.

Kohëzgjatja e mandatit të tij është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.

NENI 9
DISPOZITAT E FUNDIT

Ky akt themelimi është hartuar në 2 (dy) kopje, në gjuhën shqipe, me fuqi të njëjtë ligjore. Të dhënat tregtare të detyrueshme si dhe të dhënat e tjera për shoqërinë e sapokrijuar, gjenden të detajuara në Statutin e shoqërisë bashkangjitur. Autorizohet Administratori Z. Lenoks Milla për të kryer veprimet e regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

THEMELUESIT

FERIT ZAVALANI

Ferit Zavalani

LENOKS MILLA

Lenoks Milla

Shoqëria "ERMIR-STAR" shpk
Administrator
Romeo Lamçe

Romeo Lamçe

